

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KEBEJ OIL" SHPK

Sot me daten 18/11/2022 (dymijë e njëzet e dy), unë ortaku themelues :

- **I Z. Ronaldo Këbej**, I biri I Renato, shtetas shqiptar, i datëlindjes 06 Qershor 1996, lindur dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. J60602080H

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* " KEBEJ OIL " SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " KEBEJ OIL " SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Lagjja 15,Rruga "Aleksander Goga " , truall me nr pasurie 153/393 , zona kadastrale 8517,Spitallë ,Durrës

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Tregti të gazit, naftës,lëndëve djegëse , shitja e bombolave te gazit te te gjitha dimensioneve dhe per te gjitha perdorimet me shumice dhe pakice.. Tregtimi dhe rimbushja e bombolave te gazit. Tregtimi,transformimi, transporti i gazit te lengshem te naftes (GLN), gazit propan, gazit metan, pjeseve perberese ose perzieresve te tyre si dhe te gjitha llojeve te tjera te gazrave teknike per perdorim industrial dhe civil.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " KEBEJ OIL " SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

- 1. RONALDO KËBEJ** zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.



NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. RONALDO KËBEJ** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET



Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
"KEBEJ OIL" SH.P.K
RONALDO KËBEJ**

Ronaldo Kebej
